



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGIJË
BORDI

VENDIM

Nr. 172, Datë 26.10.2017

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “AFRIMI K” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE NGA HEC “THANZË” ME FUQI TË
INSTALUAR 2 MW.

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 gërma ‘a’ të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 13, 14 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënien, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe neni 20, pika 2 e “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thanzë” me fuqi të instaluar 2 MW, për një afat 30 – vjeçar, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatoi se:

Me vendimin e Bordit nr.138, datë 06.09.2017, ka filluar procedura, për licencimin e shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Thanzë” me fuqi të instaluar 2 MW.

Aplikimi i shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Afrimi K” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Thanzë ” me fuqi 2 MW, për një afat 30 – vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI